



Në bazë të nenit 5 dhe nenit 33 të Statutit të Universitetit AAB, Bordi i Universitetit në mbledhjen e mbajtur me datën 13.11.2006, vendosi për miratimin e rregullores së mëposhtme:

RREGULLORE PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR DHËNIEN E BURSIVE PËR STUDENTËT E DALLUAR TË UNIVERSITETIT AAB

Dispozitat e Përgjithshme

Neni 1.

Rregullorja për përcaktimin e kriterëve për dhënie e bursave për studentët e dalluar të Universitetit AAB (në tekstin e mëtejme – Rregullorja), mbështetet në Statutin dhe rregulloret e Universitetit AAB.

Neni 2.

Përmes kësaj rregulloreje, Universiteti AAB përcakton kriteret, kushtet dhe procedurat për dhënie e bursave universitare për studentë.

Me fjalën bursë nënkuptohet çdo asistencë financiare nga ana e Universitetit apo lirim nga pagesa e semestrave përkatës.

Kriteret për ndarjen e bursave

Neni 3.

Bursën Universitare mund ta fitojnë studentët të cilët i plotësojnë këto kushte:

1. Të jenë studentë të rregullt apo më korrespondencë të fakulteteve të Universitetit AAB;
2. T'i kenë dhënë të gjitha provimet nga viti paraprak i studimeve në afatin e qershorit;
3. të kenë arritur notën mesatare të studimeve 9.5;
4. të mos kenë vit të përsëritur.

Komisioni për përcaktimin e kriterëve për dhënie e bursave, përjashtimisht mund të vendosë për përcaktimin e notës më të ulët të paraparë në pikën 3 të këtij neni.



Neni 4.

Përzgjedhjen e kandidatëve e bën Komisioni për përcaktimin e kriterëve për dhënien e bursave.

Neni 5.

Informimi i studentëve për fitimin e bursës universitare bëhet përmes shërbimit të studentëve.

Dispozitat Kalimtare

Neni 6.

Kjo Rregullore mund të ndryshohet sipas procedurës së miratimit të saj.

Neni 8.

Në rast se dispozitat e kësaj Rregulloreje bien në kundërshtim me dispozitat e Statutit të Universitetit, përparësi kanë dispozitat e Statutit.

Neni 15.

Kjo rregullore hyn në fuqi më datën e miratimit të saj nga Bordi i Universitetit AAB.

Prishtinë, 2006

Kryetari i Bordit të Universitetit

Ilir Tafa